



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI**  
**AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST**  
**INFORMATION AND PRIVACY AGENCY**



Nr. Gj - 712/2024

Datë: 10.10.2024

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST INFORMATION AND PRIVACY AGENCY	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE	
Njesia Org. Org. Jodi, Org. Unit	Nr. i Prot. Br. Prot. Prot. No.
Nr. i Faqeve Broj Stranica No. of Pages	Data: Datum: Date:
03	1204
03	31 10 2024

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 20 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përkitazi me ankesën nr.712, të parashtruar më datën 19.08.2024 nga pala ankuese z. Branimir Stojanović, ndaj Komunës së Graçanicës, për kufizimin e qasjes ndaj kërkesës për qasje, të parashtruar më 31.07.2024, Agjencia për Informim dhe Privatësi nxjerr këtë:

### V E N D I M

1. Shqiptohet gjobë ndaj Komunës së Graçanicës për moszbatimin e vendimit Nr. A-712/2024 të datës 24.09.2024, në shumën prej €5,000.00 (pesë mijë eurosh) për kufizimin e qasjes në dokumente publike.
2. Obligohet Komuna e Graçanicës që shumën prej €5,000.00 (pesë mijë eurosh) ta paguajë, në afat prej 30 ditësh, në xhirrollogarinë e autoritetit kompetent për shqiptimin e gjobës nr. 1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
3. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga përmbaruesi privat.
4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas pranimit të vendimit.

### Arsyetim

Në bazë të nenit 20, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka pranuar një ankesë nga pala z. Branimir Stojanović, me nr. të protokollit 712, të datës 19.08.2024, të ushtruar ndaj Komunës së Graçanicës, për kufizim të qasjes në një pjesë të dokumenteve (të gjitha raportet [përfshirë ftesat, faturat e pagesave të shpenzimeve për dreka, shërbime hotelierike, si dhe të gjitha pagesat nga udhëtimet zyrtare të kryetares së komunës znj. Ljiljana Šubarić për vitin 2022 dhe 2023, të kryera me para të gatshme apo me kartelë bankare]) të përmendur në pikën 2.1 të dispozitivit të vendimit të datës 24 shtator 2024.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Agjencia, përmes vendimit A-712/2024 të datës 24 shtator 2024, në pajtim me nenin 20, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ka

obliguar Komunën e Graçanicës që t'i ofrojë palës dokumentet publike objekt kërkesë, të specifikuara brenda pikës 2.1 të dispozitivit të të njëjtit vendim.

Komuna e Prishtinës, me gjithë paralajmërimin e AIP-së që kishte vetëm shtatë ditë afat për t'a jetësuar kërkesën e palës ankuese, duke i ofruar dokumentet e mbetura të paofruara, nuk ka zbatuar vendimi e Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Në mungesë të reflektimit të institucionit publik, autoriteti mbikëqyrës, më 21 tetor 2024 i ka dërguar Komunës së Graçanicës Njoftimin Nr.712/2024 për Shqiptimin e Gjobës Administrative, duke i dhënë një afat prej shtatë ditësh që t'a përmirësojë shkeljen e evidentuar.

Institucioni publik, pas pranimit të njoftimit për gjobë, të nxjerrë nga AIP, ka ofruar arsyetimin e saj për mosofrimin e qëllimshëm të qasjes ndaj dokumenteve objekt kërkesë, të cilat lidhen me shpenzimin e parasë publike, qasja ndaj të cilave garantohet me nënparagrafin 3.1 të nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Arsyetimi i paraqitur nga institucioni publik, ka të bëjë me keqpërdorimin e pretenduar të informacioneve (dokumente publike) të siguruara përmes rrugës zyrtare nga Komuna e Graçanicës, duke i publikuar të njëjtat nëpër rrjete sociale, përmes të cilave, sipas institucionit publik, po prishet imazhi i Komunës së Graçanicës.

Në njërin nga takimet e zhvilluara nga AIP me përfaqësues të Komunës së Graçanicës, gjatë procesit të shqyrtimit të kësaj ankese, të njëjtëve u është bërë e ditur që në rastet kur ekzistojnë dëshmi për shtrembërimin e përmbajtjes së informacioneve të marra nga Komuna e Graçanicës, përmes një kërkesë për qasje në dokumente publike, çështja duhet adresuar në gjykatën kompetente.

Për më tepër, të pranishëmve në takim u është sqaruar që neni 24 i LQDP-së e garanton ripërdorimin e dokumenteve (siç mund të jetë edhe publikimi i tyre).

Megjithkëtë, institucioni publik ka zgjedhur që të mos ofrojë qasje ndaj dokumenteve nga pika 2.1 e të njëjtit vendim.

Më 29 tetor 2024, pala ankuese e ka rikonfirmuar mospranimin e dokumenteve të kërkuara nga institucioni publik, i cili ka shërbyer si tregues për mungesën e vullnetit të Komunës së Graçanicës për të zbatuar vendimin e karakterit detyrues të autoritetit mbikëqyrës.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, duke vënë re qasjen mospërfillëse të këtij institucioni publik për të jetësuar në plotni të drejtën e palës ankuese, është detyruar të vazhdojë me hapin e radhës të shqyrtimit të kësaj ankese, duke nxjerrë Vendimin Nr. Gj-712/2024, përmes të cilit i shqiptohet gjobë institucionin publik në fjalë, shuma e së cilës bazohet në paragrafin 1 të nenit 33 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nenin 20, nënparagrafi 4 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka nxjerrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për kundërshtim në gjykatën kompetente për çështje administrative brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



*Jeton Arifi*  
Jeton Arifi  
Drejtor  
Departamenti për Qasje  
në Dokumente Publike

Vendimi i dërgohet:

- Znj. Ljiljana Šubarić, Zyrtare Përgjegjëse, Komuna e Graçanicës
- Z. Branimir Stojanović, Ankues
- Arkivit të Agjencisë